



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.139

5 shtator

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.1183, datë 5.8.2008	Për miratimin e rregullores “Për administrimin e qendrës historike dhe të zonës së mbrojtur, në qytetin e Shkodrës” 6167
Vendim i KM nr.1184, datë 20.8.2008	Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit e të emërimit, të afateve të kalimit nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë karriere dhe për marrjen e masave disiplinore për punonjësit e administratës tatimore qendrore..... 6173
Vendim i KM nr.1189, datë 20.8.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Myhejan 1”, “Myhejan 2” e “Myhejan 3”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë 6183
Vendim i KM nr.1190, datë 20.8.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Fterre”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë 6184
Vendim i KM nr.1191, datë 20.8.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Langarica 3”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë 6184
Vendim i KM nr.1192, datë 20.8.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Qafëzez”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë ... 6185
Vendim i KM nr.1193, datë 20.8.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Koka 1”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë ... 6185

Vendim i KM nr.1194, datë 29.8.2008	Për lejimin e kalimit transit të gjashtë autokolonave dhe trupave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë..	6186
Vendim i KM nr.1199, datë 27.8.2008	Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe “Polar” sh.p.k.-së, për burimin ujor 6/1, Uji i Ftohtë, Vlorë	6187
Udhëzim i KM nr.1, datë 20.8.2008	Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2008	6187
Udhëzim i MF&MBUMK nr.2, datë 1.8.2008	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.848, datë 11.6.2008 “Për kthimin e fondeve financiare nga subjektet, që kanë përfituar nga përdorimi i fondeve të granteve japoneze si mbështetje buxhetore “Non Project Grand Aid” (NPGA), për sektorin e bujqësisë dhe ushqimit	6191
Kërkesë e MPPTT nr.3699/1, datë 21.8.2008	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Sarandë-Krane-Konispol	6192

VENDIM
Nr.1183, datë 5.8.2008

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ADMINISTRIMIN E QENDRËS HISTORIKE
DHE TË ZONËS SË MBROJTUR, NË QYTETIN E SHKODRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 29 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullore “Për administrimin e qendrës historike dhe të zonës së mbrojtur, në qytetin e Shkodrës”, sipas tekstit dhe hartës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR ADMINISTRIMIN E QENDRËS HISTORIKE DHE ZONËS SË MBROJTUR TË SAJ NË
QYTETIN E SHKODRËS

Neni 1

Qëllimi dhe objektivat

Kjo rregullore ka për qëllim:

Miratimin e rregullave për administrimin, mbrojtjen, restaurimin dhe rijetëzimin e qendrës historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Shkodrës.

Objektivat kryesorë të kësaj rregulloreje janë:

a) mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike dhe mjedisore të qendrës historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Shkodrës, sipas hartës, pjesë integrale e kësaj rregulloreje;

b) administrimi i qendrës historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Shkodrës;

c) mënyrat e bashkëpunimit të institucioneve të ngarkuara për mbrojtjen, restaurimin dhe miradministrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të qytetit të Shkodrës, me njësitë e qeverisjes vendore.

Neni 2

Baza ligjore

Trashëgimia kulturore dhe historike e qendrës historike dhe zonës së mbrojtur të Shkodrës, mbrohet nga ligji nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, me ndryshimet, kjo rregullore dhe rregulla të tjera në fuqi.

Neni 3

Struktura e qendrës historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Shkodrës

Qendra historike dhe zona e mbrojtur e qytetit të Shkodrës konsiderohen si dokumentet më me vlerë të historisë së zhvillimit të këtij qyteti, pjesë e trashëgimisë kulturore shqiptare.

I. Qendra historike përfshin:

a) ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës “13 Dhjetori” (kufizuar në j-p me kryqëzimin në Parrucë dhe në v-l me sheshin e qytetit);

b) ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës “Kol Idromeno” (kufizuar në j-p me sheshin e qytetit dhe në v-l me rrugën “Daniel Matlia”);

c) ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës “Kardinal Mikel Koliqi” (kufizuar në v-p me rrugën “Kol Idromeno” dhe në j-l me rrugën “Skënderbeg”)

II. Zona e mbrojtur përfshin:

- a) Ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës “Aleksandër Moisiu”;
- b) Ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës “Bardhok Biba”;
- c) Ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës “Gurazezëve”;
- d) Ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës “Gurakuqëve”;
- e) Ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës “Murgeshave”;
- f) Ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës “Ndre Mjeda”;
- g) Ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës pas Kafes së Madhe.

Neni 4

Qendra historike

Qendra historike është pjesa më me vlerë e qytetit të Shkodrës. Ajo ruhet në tërësinë e saj si kompleks monumental me vlera historike, urbanistike, arkitektonike dhe ambientale. Këtu bëjnë pjesë ndërtesat në të dy anët e rrugëve të përmendura në nenin 3 pika 1 dhe vetë rrugët, trotualet, muret e avllive, portat, si dhe strukturat e ndriçimit, dekorit, gjelbërimit.

Në këtë zonë nuk lejohen ndërtime të reja, por lejohen vetëm ndërhyrjet restauruese dhe konservuese, si dhe rikonstruksione të ndërtimeve ekzistuese, vetëm pasi projekti i ndërhyrjes të jetë miratuar më parë në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve. Plotësimi i nevojave më të domosdoshme për të realizuar funksionet administrative dhe social-kulturore, zgjidhet duke shfrytëzuar monumentet e kulturës që ruhen brenda kësaj zone, pa cenuar vlerat për të cilat ato janë vënë në mbrojtje.

Për secilin nga monumentet e kulturës të kategorisë së I-rë apo të II-të, pjesë përbërëse të qendrës historike, përcaktohen në përmasa, nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, pas studimit dhe propozimit nga IMK-ja, një sipërfaqe toke përreth monumentit, si zonë mbrojtëse, në përputhje me vlerat e tyre arkitektonike, me përshtatshmërinë urbanistiko-estetike dhe me rrethana të tjera që kanë të bëjnë me monumentin. Në zonën mbrojtëse përreth monumentit ndalohet çdo lloj ndërhyrje me karakter ndërtimor.

Në monumentet e kategorisë së I-rë dhe të II-të të qendrës historike ndalohet vendosja në mënyrë të dukshme e elementeve, të cilat prishin pamjen dhe pengojnë fotografimin, filmimin dhe sositjen normale.

Ndalohen vendosja e reklamave, dekoreve, posterave, qofshin këto dhe provizore, në kundërshtim me ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, me ndryshime.

Këto veprime përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në përputhje me ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, me ndryshime, neni 28, pika 2.

Neni 5

Zona e mbrojtur e qendrës historike

Zona e mbrojtur me vlerën e saj plotësuese historike, urbanistike, arkitektonike dhe ambientale luan një rol me rëndësi të veçantë në tërësinë e trashëgimisë kulturore të paluajtshme për qytetin e Shkodrës. Krahas ndërtimeve me vlera historike, urbanistike dhe arkitektonike, në këtë zonë ka dhe ndërtime pa vlera, të cilat nuk harmonizohen me ato tradicionale dhe paraqesin nevojën për rikonstruksion, rindërtim apo riformulim nga ana urbanistike dhe arkitektonike. Për rrjedhojë, në këto zona lejohen rikonstruksionet e ndërtimeve ekzistuese, përshtatje, shtesa dhe ndërtime të reja në harmoni me karakteristikat e zonës, kur nevojat e domosdoshme për të cilat kërkohen, nuk zgjidhen brenda kuadrit ekzistues. Në këtë drejtim, këto zona duhet t’u nënshtrohen studimeve të kujdesshme urbanistike dhe arkitektonike për çdo ndërhyrje si në ndërtesë, ashtu dhe në drejtim të peizazhit urban (truall, rrugë, trotualet, avlli, gjelbërim, ndriçim, dekor). Për ndërtime të reja të respektohen kriteret e renditura në nenin 8 të kësaj rregulloreje. Në çdo rast projekti i çdo ndërtimi në këtë zonë miratohet nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

Në monumentet e kategorisë së I-rë dhe të II-të të zonës së mbrojtur ndalohet vendosja në mënyrë të dukshme e elementeve, të cilat prishin pamjen dhe pengojnë fotografimin, filmimin dhe sositjen normale.

Ndalohet vendosja e reklamave, dekoreve, posterave, qofshin këto dhe provizore, në kundërshtim me ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, me ndryshime.

Këto veprime përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në përputhje me ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, me ndryshime, neni 28, pika 2.

Neni 6

Studimi dhe projektimi për restaurimin e monumenteve

Studimi dhe projektimi i konservimit dhe restaurimit, në monumentet e kategorisë së parë dhe të dytë, bëhet nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Shkodër apo institucione dhe subjekte të tjera të specializuara dhe të licencuara sipas ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, me ndryshime. Çdo projekt shqyrtohet prej Këshillit Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohet nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

Neni 7

Zbatimi i punimeve të konservimit dhe restaurimit

Zbatimi i punimeve për konservime dhe restaurime në monumentet e kulturës të kategorisë I ose kategorisë II bëhet nga IMK-ja, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Shkodër apo institucione dhe subjekte të tjera të specializuara dhe të licencuara sipas ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar.

Punimet e konservimit dhe restaurimit në ansamblet arkitektoniko-urbanistike të ndodhura në qendrën historike apo në zonën e mbrojtur, duke përfshirë këtu trotualet, pamjet e ndërtesave që dalin në rrugë, muret e avllive, portat e jashtme dhe elemente të tjera urbanistiko-arkitektonike, kryhen nga DRKK-ja Shkodër ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për këtë qëllim. Përfshihet bën ngritja apo rikonstrukcioni i rrjetit inxhinierik nëntokësor, linja ajrore të telefonisë apo tensionit, si dhe shtrimi i rrugëve me sfalto beton, punime për të cilat leja miratohet edhe nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve. Punimet në këto raste mbikëqyren edhe nga përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Shkodër.

Neni 8

Urbanistika dhe kriteret e projektimit për rikonstrukcione, përshtatje dhe ndërtime të reja në zonën e mbrojtur

Planet rregulluese të Shkodrës jashtë qendrës historike duhet të kenë karakter harmonizues me traditën. Brenda zonës së mbrojtur, çdo lloj ndërtimi duhet të jetë në volumet tradicionale dhe asnjëherë pengesë për soditjen e qendrës historike.

I. Rikonstrukcionet në zonën e mbrojtur duhet të ndjekin këto kritere në projektimin arkitektoniko-urbanistik:

a) Rikonstrukcionet dhe përshtatjet nuk duhet të dëmtojnë karakteristikat tradicionale të banesave në zonën e mbrojtur të Shkodrës. Veçanërisht nga pikëpamja arkitekturore ato duhet të jenë në harmoni me këto banesa, duke respektuar përpjesëtimet urbanistike e vëllimore, trajtimi arkitekturor dhe elementet arkitektonike. Instituti i Monumenteve të Kulturës, IMK, jep këshilla arkitekturore të nevojshme për respektimin e këtyre detyrimeve.

b) Në rastin e rikonstrukcioneve të ndërtimeve ekzistuese, ato duhet të ruajnë trajtimin origjinal të pamjeve të jashtme, duke respektuar volumin ekzistues, ndërsa brendësia e tyre mund të ndryshojë duke respektuar elemente të veçanta me vlerë për trashëgiminë kulturore.

c) Çatitë e objekteve të rikonstrukcioneve në ndërtimet ekzistuese, duhet të jenë të njëjtit lloj me ato të ndërtimeve origjinale përreth. Mbulesa duhet të jetë me tjegulla vendi qeramike, pjerrësia pa kaluar 25 gradë, pajisur me ulluk.

d) Nëse do të përdoren struktura dhe materiale të reja të kohës, si betoni etj., ato do të jenë të fshehura dhe të mos dallohen në pamjet e jashtme të ndërtesës.

e) Materiali, madhësia, ngjyra e dyerve dhe dritareve, si dhe ngjyra e fasadës së banesës përcaktohen dhe miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit.

f) Materiali i mureve rrethuese, lartësia dhe ngjyra e tyre përcaktohen dhe miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit.

II. Ndërtimet e reja në zonën e mbrojtur duhet të ndjekin këto kritere në ndërtimin arkitektoniko-urbanistik:

a) Ndërtime të reja bëhen vetëm në ato troje, në të cilat leja e ndërtimit nuk bie ndesh me ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, këtë rregullore, ligji për urbanistikën dhe rregulla të tjera në fuqi.

b) Ndërtimi i ri duhet të zërë jo më shumë se 40% të sipërfaqes së truallit.

c) Lartësia e ndërtesës së re duhet të jetë maksimalisht 10 metra nga sipërfaqja e tokës. Katet nëntokësorë janë të lejuara dhe numri i tyre caktohet me vendim të KKR-së. Tavani i katit nëntokësor nuk duhet të kalojë lartësinë prej 50 cm nga niveli i truallit.

d) Catitë e ndërtimeve të reja duhet të jenë të njëjtit lloj me ato të ndërtimeve origjinale përreth. Mbulesa duhet të jetë me tjegulla vendi qeramike, pjerrësia pa kaluar me 25 gradë, pajisur me ulluk.

e) Nëse do të përdoren struktura dhe materiale të reja të kohës, si betoni etj., ato do të jenë të fshehura dhe të mos dallohen në pamjet e jashtme të ndërtesës.

f) Materiali, madhësia, ngjyra e dyerve dhe dritareve, si dhe ngjyra e fasadës së banesës përcaktohen dhe miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit.

g) Materiali i mureve rrethuese, lartësia dhe ngjyra e tyre përcaktohen dhe miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit.

Si në rikonstruksionet, edhe në ndërtimet e reja punimet mbikëqyren edhe nga përfaqësuesi i DRKK-së, Shkodër. Mosrespektimi i pikave të këtij neni përbën kundërvajtje administrative dhe kundërvajtësit dënohen me gjobë në përputhje me ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar, neni 28, pika 2.

Ndërtimet, pamja e të cilave bie ndesh me këtë rregullore, trajtohen sipas ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”.

Neni 9

Komiteti mbikëqyrës i qendrës historike dhe zonës së mbrojtur

Për zbatimin korrekt të kësaj rregulloreje, pranë bashkisë së qytetit Shkodër ngrihet komiteti mbikëqyrës i qendrës historike dhe zonës së mbrojtur, një strukturë këshillimore, jofunksionale, me përfaqësues të njësisë së pushtetit vendor, përfaqësues e specialistë të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Shkodër, si dhe të institucioneve të tjera të specializuara. Ky komitet këshillon dhe rekomandon strukturave përgjegjëse të trashëgimisë kulturore masa për përmirësimin dhe arritjen e standardeve kombëtare për miradministrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të qytetit të Shkodrës.

Komiteti përbëhet nga 7 anëtarë. Kryetar i komitetit mbikëqyrës caktohet kryetari i bashkisë së qytetit të Shkodrës.

Rregullorja e funksionimit të komitetit mbikëqyrës dhe emrat e anëtarëve propozohen nga vetë subjektet përfaqësuese në komitet dhe miratohen me vendim të kryetarit të bashkisë Shkodër. Komiteti mbikëqyrës i qendrës historike dhe zonës së mbrojtur bashkëpunon me organet e pushtetit vendor dhe atij qendror, në bazë të marrëveshjeve të përbashkëta midis tyre.

Neni 10

Dispozita të fundit

Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.


Kësaj rregulloreje i bashkëngjitet harta e kufijve të qendrës historike dhe zonës së mbrojtur të saj të qytetit të Shkodrës.

Neni 11

Sanksione

Për shkeljen e kësaj rregulloreje, zbatohen sanksione mbështetur në ligjin nr.9048, datë

7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar, rregulla të tjera në fuqi, vendimet e KKR-së dhe të këshillit bashkiak Shkodër.



ZONË E MBROJTUR
QENDRA HISTORIKE DHE ZONË E MBROJTUR

MIRATOHET

KRYETARI I KESHILLIT
MINISTRAVE

SALI BERISHA

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTUR
RINISE DHE SPORTEVE



VENDIM NR. ____ DT. ____ / ____ / 2008

INSTITUTI I MONUMENTEVE T
KULTURES
DREJTORI

LORENÇ BEJKO



LEGJENDA

- QENDRA HISTORIKE DHE ASAMBLET URBANISTIKO-ARKITEKT
- ZONA E MBROJTUR (TAMPON)
- MONUMENTE KATEGORISE SE I
- MONUMENTE TE KATEGORISE SE II

VENDIM
Nr.1184, datë 20.8.2008

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT E TË EMËRIMIT, TË AFATEVE TË KALIMIT NGA NJË NIVEL MË I ULËT NË NJË NIVEL MË TË LARTË KARRIERE DHE PËR MARRJEN E MASAVE DISIPLINORE PËR PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS TATIMORE QENDRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 20, pikat 2 e 3, dhe 22, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Të përgjithshme

1. Për rekrutimin e nëpunësve të administratës tatimore qendrore zbatohet legjislacioni në fuqi për nëpunësit civilë për institucionet e pavarura, me përjashtim të kategorisë së punonjësve, marrëdhëniet e punësimit të të cilëve rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve merr masat për respektimin e dispozitave të legjislacionit për nëpunësit civilë, për institucionet e pavarura, dhe të kriterëve të këtij vendimi, për:

- rekrutimin e punonjësve;

- emërimet dhe lëvizjet e punonjësve;

- kohën, afatet dhe plotësimin e kushteve të tjera, për kalimin nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë karriere, të punonjësve të administratës tatimore qendrore.

3. Personeli, sipas detyrave, ndahet në punonjës të nivelit të lartë, të mesëm e të ulët drejtues dhe në punonjës ekzekutues, të kategorizuar sipas këtij vendimi.

- a) Drejtor i përgjithshëm i përgjigjet klasifikimit: nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues;

- b) Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i përgjigjet klasifikimi: nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues;

- c) Kategoria A i përgjigjet klasifikimit: nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues. Në këtë kategori përfshihen funksionet: drejtor drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe drejtor i drejtorisë rajonale;

- ç) Kategoria B i përgjigjet klasifikimit: nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues. Në këtë kategori përfshihen funksionet: drejtor drejtorie në drejtorinë rajonale dhe përgjegjës sektori në Drejtorinë e Përgjithshme;

- d) Kategoria C1 i përgjigjet klasifikimit: nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues. Në këtë kategori përfshihen funksionet: përgjegjës sektori/zyre në drejtorinë rajonale dhe njësitë e ngjashme me to dhe përgjegjës zyre në Drejtorinë e Përgjithshme;

- dh) Kategoria C2 i përgjigjet klasifikimi: nëpunës civil i nivelit ekzekutues. Në këtë kategori përfshihen inspektorët, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të nivelit IVA, dhe inspektorët në drejtoritë rajonale dhe njësitë e ngjashme me to, të nivelit IVA;

- e) Kategoria C3 i përgjigjet klasifikimit: inspektor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të nivelit IVB, dhe inspektor në drejtoritë rajonale dhe njësitë e ngjashme me to, të nivelit IVB;

- ë) Kategoria D1 përfshin personelin ndihmës si: llogaritar, arkëtar, shofer, magazinier, arkivist, sekretar, protokollist, centralist etj. dhe personel tjetër, të ngjashëm me to;

- f) Kategoria D2 përfshin personelin tjetër ndihmës, që kryen shërbimet sanitare dhe të mirëmbajtjes së zyrave.

Marrëdhëniet e punës për personelin e kategorive D1 e D2 rregullohen nga dispozitat e Kodit të Punës.

4. Struktura organizative dhe numri i përgjithshëm i personelit të administratës tatimore qendrore miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Financave, pas bashkërendimit me DAP-in, ndërsa organigrama e administratës tatimore qendrore miratohet nga Ministri i Financave, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

II. Rekrutimi dhe vlerësimi i personelit

5. Rekrutimi i personelit të administratës tatimore

5.1 Në përputhje me nenin 19 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” e me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil, si dhe me natyrën e veçantë të administratës tatimore, vendet e lira, brenda administratës, plotësohen në varësi të kategorisë dhe të natyrës së pozicionit, nëpërmjet njërës prej procedurave të mëposhtme:

- a) Me transferimin e personelit tatimor brenda së njëjtës kategori.
 - b) Me ngritjen në kategori, nëpërmjet konkurrimit, të personelit tatimor ekzistues të një kategorie më të ulët.
 - c) Me rekrutimin e personelit, nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur.
- 5.2 Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, më poshtë (DPT), në zbatim të strukturës analitike të miratuar dhe nevojave funksionale, shpall vendet e lira. Drejtori i përgjithshëm i tatimeve, me propozimin e drejtorit të drejtorisë së burimeve njerëzore, miraton procedurën e konkurrimit për këto vende të lira.

Përzgjedhja e kandidatëve bazohet në vlerësimin e përshtatshmërisë së tyre me kërkesat e përshkrimit të vendit të lirë të punës dhe me kriteret e përcaktuara në aneksin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5.3 Përbëjnë përjashtim nga kriteret e edukimit arsimor, të përcaktuara në aneksin nr.1, për pozicionet në nivelet A, B, C1, C2 e C3 të administratës tatimore qendore rastet e mëposhtme:

- a) Rekrutimi i punonjësve të teknologjisë së informacionit;
- b) Rekrutimi i punonjësve të zbatimit, të drejtorisë së investigimit;
- c) Rekrutimi i punonjësve të sektorit të administratës dhe prokurimeve, në drejtorinë e financës, administratës dhe prokurimeve;
- ç) Rekrutimi i punonjësve ekzekutues të niveleve C3 e C2, të drejtorisë së marrëdhënieve me jashtë;
- d) Rekrutimi i punonjësve me përvojë mbi 4 vjet në strukturat tatimore qendrore dhe me kualifikime në fushën e tatimeve;
- dh) Rekrutimi i specialistëve të niveleve C3 e C2 (inxhinier, teknolog etj.), të nevojshëm në strukturat e kontrollit tatimor.

Vlerësimi i përbushjes së këtyre kriterëve bëhet nga drejtoria e burimeve njerëzore, në DPT. Në rastet e rekrutimeve të përmendura në këtë pikë, kriteri arsimor zbatohet sipas kërkesave të veçanta, që i përgjigjen vendit të punës.

5.4 Në zbatim të nenit 17 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, kërkesat për postin e drejtorit të përgjithshëm të tatimeve do të jenë të hapura.

Për këtë post, Ministri i Financave i propozon Kryeministrit kandidaturat, që plotësojnë kriteret e përcaktuara në aneksin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5.5 Në zbatim të nenit 17 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, kërkesat për postin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm janë të hapura.

Drejtori i përgjithshëm i propozon për miratim Ministrit të Financave kandidaturat, që plotësojnë kriteret e përcaktuara, në aneksin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Pranimi i nëpunësve të administratës tatimore.

Pranimi i nëpunësve të administratës tatimore kryhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, në bazë të meritave.

Konkurrimi zhvillohet në tri faza:

a) Shpallja e konkurrimit bëhet nga drejtoria/sektori apo zyra e personelit dhe përmban kërkesat e përgjithshme, të përcaktuara në vendimin nr.231, datë 11.5.2000 të Këshillit të Ministrave, si dhe kriteret e veçanta për secilin pozicion, të përcaktuara në aneksin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Drejtorja/sektori apo zyra e personelit përkatës në administratën tatimore qendrore bën përzgjedhjen e kandidatëve, që do t'i nënshtrohen testimit, pasi vlerëson se kandidatët plotësojnë kërkesat, e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim. Ankimi në këtë fazë bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil.

b) Testimi, i cili bëhet me shkrim dhe me gojë. Drejtoria/sektori apo zyra e personelit përkatës në administratën tatimore qendrore ngre komitete të veçanta, me 5 anëtarë, përkatësisht zëvendës drejtorin e përgjithshëm të shërbimeve mbështetëse, drejtorin/përfaqësuesin e zyrës sektorit të shërbimeve mbështetëse, eprorin direkt për pozicionin e vendit të shpallur të lirë dhe dy personalitete të fushës, ekonomike, me profil finance dhe juridike.

Komiteti harton një listë me tre kandidatët me rezultatet më të larta, duke u bazuar kryesisht në rezultatet e testimeve, por edhe në kualifikimet, përvojën profesionale dhe botimet shkencore.

Rezultatet e testimit dhe pikët maksimale janë, përkatësisht, 70 pikë në rezultatin e testimit, 10 pikë për përvojën në punë të kandidatit, 8 pikë për kualifikimet, 8 pikë për botimet shkencore dhe 4 pikë për aftësitë personale, të veçanta.

c) Vlerësimi nga komiteti të 3 kandidatëve me pikët më të larta. Rezultati shpallet në një vend të dukshëm. Drejtori i përgjithshëm i tatimeve zgjedh njërin nga tre kandidatët e përzgjedhur nga komiteti.

Drejtorja/sektori apo zyra e personelit, brenda 4 ditëve, boton rezultatin e konkurrimit në dy gazetat kombëtare, me qarkullim më të madh.

7. Ngritja në kategori

Ngritja në kategori përbën kalimin nga një kategori më e ulët në një kategori më të lartë.

Procedura e ngritjes në kategori, nëpërmjet përzgjedhjes së kandidatëve nga brenda administratës tatimore.

7.1 Procedura për ngritjen në kategorinë C1

7.1.1 Në procedurën e ngritjes në kategorinë C1 lejohen të marrin pjesë kandidatët, që janë të punësuar në sistemin tatimor qendror, në kategorinë C2, dhe që kanë shërbyer në këto kategori për të paktën 2 (dy) vjet, pa ndërprerje, me kusht që të plotësojnë kërkesat e përcaktuara për secilën kategori, në aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Në rast se numri i punonjësve ekzistues, kandidatë për vendin e lirë, është më i vogël se 4, zbatohen procedurat e konkurrimit të hapur për shtetasit, që plotësojnë kriteret, e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në aneksin nr.1.

7.1.2 Forma e ngritjes në kategorinë C1 bëhet me testim, me shkrim dhe intervistë, pas verifikimit paraprak të dosjeve të kandidatëve, sipas procedurave të mëposhtme:

Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT shpall konkurrimin për vendet e lira të punës për kategorinë C1. Njoftimi përmban:

- a) Numrin dhe vendndodhjen e vendeve të lira të punës;
- b) Kushtet e veçanta për të marrë pjesë në testim;
- c) Listën e dokumenteve, që duhen paraqitur;
- ç) Procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes;
- d) Afatin dhe vendin e dorëzimit të dokumenteve;
- dh) Cilësitë e kërkuara për t'u pranuar në konkurrim;
- e) Kufizimet në moshë, nëse është e domosdoshme;
- ë) Ndonjë kërkesë të veçantë, për ndonjë vend pune të veçantë;
- f) Datën, kohën dhe vendin, ku do të kryhet testimi me shkrim;
- g) Materialet teorike, mbi të cilat do të mbështetet testimi.

7.1.3 Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë dokumentacionin e kërkuar brenda afateve të përcaktuara, pranë zyrës së sekretarisë, ku do të bëhet dhe protokollimi. Për aplikim për ngritjen në kategori, kandidati duhet të mos ketë në dosjen personale masa disiplinore për një periudhë 1-vjeçare.

7.1.4 Ministri i Financave ngre një komision, me kryetar zëvendës drejtorin e përgjithshëm të shërbimeve mbështetëse, ku bëjnë pjesë drejtori/përfaqësuesi i zyrës/sektorit të shërbimeve mbështetëse, eprori direkt për pozicionin e vendit të shpallur të lirë dhe dy personalitete të fushës ekonomiko-financiare ose juridike.

Personat, që nuk janë pjesë e administratës tatimore, përfitojnë shpërblim, në përputhje me vendimin nr.231, datë 11.5.2000 të Këshillit të Ministrave, dhe paguhet nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

7.1.5 Vlerësimi për secilën fazë, me shkrim dhe për intervistën, bëhet sipas vlerësimit të përcaktuar në pikën 6 të këtij vendimi.

7.1.6 Komisioni harton dhe publikon listën e të gjithë kandidatëve, të cilët kanë kaluar testimin me shkrim dhe intervistën, të renditur sipas pikëve të marra. Emërimet bëhen duke filluar nga kandidatët fitues me rezultatin më të lartë, derisa të plotësohen të gjitha vendet e lira të punës, të shpallura në konkurrim.

7.1.7 Drejtoria, seksioni/zyra e personelit, brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit, të drejtorit të përgjithshëm të DPT-së shpall emërimet dhe, në rastet e moskualifikimit, personat njoftohen për

arsyet e refuzimit.

7.2 Procedura për ngritjen në kategoritë B e A

Për ngritjen në kategoritë B e A lejohen të marrin pjesë kandidatët, të cilët, në çastin e konkurrimit, punojnë, përkatësisht, në kategoritë C1 e B dhe që plotësojnë këto kushte:

- a) Për kategorinë B, të ketë punuar, pa ndërprerje, 2 (dy) vjet në kategorinë C1;
- b) Për kategorinë A, të ketë punuar, pa ndërprerje, 2 (dy) vjet në kategorinë B1.

Në rast se numri i punonjësve ekzistues, kandidatë për vendin e lirë, është më i vogël se 4, zbatohen procedurat e konkurrimit të hapur për shtetasit, që plotësojnë kriteret, e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në aneksin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Konkursi është i hapur dhe për persona me kualifikime të veçanta pasuniversitare ose personat që kanë kryer studime në vendet perëndimore, në fushat, që përcaktohen në aneksin nr.1.

Komisioni i përzgjedhjes për kategoritë B e A përbëhet nga zëvendësudrejtori i përgjithshëm i shërbimeve mbështetëse, në cilësinë e kryetarit, zëvendësudrejtori i operacioneve, zëvendësudrejtori i të ardhurave dhe informacionit dhe dy personalitete të fushës ekonomiko-financiare ose juridike.

Personat, që nuk janë pjesë e administratës tatimore, përfitojnë shpërblim, në përputhje me vendimin nr.231, datë 11.5.2000 të Këshillit të Ministrave, dhe paguhet nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Vlerësimi për secilën fazë, me shkrim dhe për intervistën, bëhet sipas vlerësimit të përcaktuar në pikën 6 të këtij vendimi.

Drejtorja, seksioni/zyra e personelit bën emërimet, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së vendimit nga drejtori i përgjithshëm dhe, në rastet e moskualifikimit, personi njoftohet edhe për arsyet e refuzimit.

7.2.1 Ngritja në kategorinë B bëhet si më poshtë vijon:

a) Për punonjësit ekzistues, përmes testimit me shkrim dhe një interviste, në përputhje me pikën 6 të këtij vendimi.

b) Në rast se numri i punonjësve ekzistues, kandidatë për vendin e lirë, është më i vogël se 4, zbatohen procedurat e konkurrimit të hapur për shtetasit, që plotësojnë kriteret, e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në aneksin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) Drejtorja e Burimeve Njerëzore njofton për vendet e lira të punës për kategorinë B, objekt konkurrimi. Njoftimi për shpalljen e vendeve të lira të punës përmban elementet, që përcaktohen në pikën 7.1.2.

ç) Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë, brenda afateve të përcaktuara në njoftim, dokumentacionin e kërkuar dhe ta depozitojnë pranë sekretarisë.

d) Për të aplikuar për ngritjen në kategori, kandidati duhet të mos ketë në dosjen personale masa disiplinore, për të paktën 1 vit përpara datës së konkurrimit.

dh) Për konkurrimin në kategorinë B zbatohet parimi një fitues për çdo vend të lirë dhe nuk ka listë pritjeje. Për këtë vend pune emërohet kandidati që, në testim, në total, ka fituar pikët më të larta.

7.2.2 Ngritja në kategorinë A bëhet si më poshtë vijon:

a) Për punonjësit ekzistues, nëpërmjet testimit me shkrim dhe intervistës.

b) Në rast se numri i punonjësve ekzistues, kandidatë për vendin e lirë, është më i vogël se 4, zbatohen procedurat e konkurrimit të hapur për shtetasit, që plotësojnë kriteret, e përgjithshme dhe të veçanta, për këtë kategori, të përcaktuara, në aneksin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) Vlerësimi bëhet në përputhje me pikën 6 të këtij vendimi.

ç) Drejtorja e Burimeve Njerëzore bën njoftim për vendet e lira të punës, për kategorinë A. Njoftimi për shpalljen e vendeve të lira të punës duhet të përmbajë elementet e përcaktuara në pikën 7.1.2.

d) Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë, brenda afateve të përcaktuara në njoftim, dokumentacionin e kërkuar dhe ta depozitojnë pranë sekretarisë.

dh) Komisioni i përzgjedhjes së kandidatëve, me përbërje sipas shkronjës “b” të pikës 6 të këtij vendimi, merr në shqyrtim të gjitha kërkesat e paraqitura për ngritjen në kategori dhe bën vlerësimin për secilin kandidat.

e) Fitojnë të drejtën për testim konkurrentët, që kanë dokumentacionin e kërkuar të plotë dhe që nuk kanë në dosjen personale masa disiplinore, të paktën 1 vit përpara datës së konkurrimit.

ë) Komisioni i përzgjedhjes, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, u komunikon konkurrentëve kualifikimin për testim, si dhe datën dhe vendin, ku do të zhvillohet ai.

f) Përveç përvojës profesionale, në vlerësimin me pikë të kandidatit gjatë intervistimit, ndikojnë edhe vendi, ku ai ka kryer studimet universitare, rezultatet e arritura, specializimet pasuniversitare, master/doktoraturë, dhe rezultatet e arritura në to, testimi praktik i gjuhës së huaj, të folur dhe të shkruar, vizioni për postin, për të cilin konkurren.

8. Dispozita të përbashkëta për përzgjedhjen e kandidatëve nga brenda dhe jashtë administratës tatimore qendrore

Pas përfundimit të konkurrimit shpallet lista e kandidatëve fitues për vendet e lira.

8.1 Kandidatët, që nuk fitojnë, mund të paraqesin, pranë Komisionit të Shërbimit Civil, brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së rezultateve të konkurrimit, ankesën për zhvillimin dhe rezultatin e konkurrimit.

8.2 Zyrtarët e emëruar nga jashtë në kategoritë C3, C1, B e A i nënshtrohen një periudhe prove 1-vjeçare. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, me plotësimin e këtij afati, duke marrë edhe mendimin e eprorit direkt, i propozon drejtorit të përgjithshëm emërimin ose jo të punonjësit. Sipas rastit, eprori direkt mund ta zgjasë periudhën e provës edhe për 6 muaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil.

Drejtori i përgjithshëm, brenda 5 ditëve, vendos për emërimin ose jo të punonjësit.

8.3 Administrata tatimore qendrore siguron se të gjitha fazat e procedurave të emërimit, që kanë të bëjnë me ngritjen në kategori, nga brenda administratës tatimore qendrore ose jashtë saj, të regjistrohen dhe të dokumentohen në mënyrë të plotë. Të gjitha dokumentet, përfshirë edhe fletët e provimit, si dhe vlerësimet përfundimtare të komisioneve gjatë intervistave, ruhen nga administrata, në përputhje me ligjin “Për arkivat”.

9. Ngritja e përkohshme në kategori

9.1 Për nevoja operacionale të argumentuara, drejtori/shefi i burimeve njerëzore, për jo më shumë se 10 për qind të numrit të përgjithshëm të punonjësve për secilën strukturë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, mund të kërkojë plotësimin e mënjëhershëm të një vendi të lirë pune apo të një vendi pune të sapokrijuar, për ngritje të përkohshme në kategori të punonjësve ekzistues, ose të kontraktuajë punonjës jashtë administratës tatimore qendrore.

9.2 Ngritjet e përkohshme në kategori zgjasin vetëm për një afat kohor maksimal tremujor, gjatë të cilit administrata duhet të zbatojë procedurat përkatëse dhe aktet, ligjore e nënligjore, për plotësimin përfundimtar të këtij vendi pune.

9.3 Gjatë kësaj periudhe, punonjësi gëzon të drejtën e pagesës për kategorinë e pozicionit dhe të përfitimeve, që rrjedhin nga ndryshimi i vendndodhjes së vendit të punës.

9.4 Zyrtarët e ngritur përkohësisht në kategorinë dhe që nuk kanë fituar në procedurën e ngritjes në kategorinë për postin e dhënë përkohësisht, rikthehen, në përfundim të afatit kohor tremujor në pozicionin dhe vendndodhjen e tyre të mëparshme.

9.5 Ministri i Financave, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të tatimeve, miraton ngritjen e përkohshme në kategori për zëvendësdrejtorët e përgjithshëm dhe punonjësit e kategorisë A.

9.6 Drejtori i përgjithshëm i tatimeve, me propozimin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, miraton ngritjet e përkohshme në kategori për punonjësit e kategorive B dhe C1.

10. Punësimi i personelit ndihmës

Personeli i kategorive D1 e D2 përzgjidhet nga komisioni, i përbërë nga zëvendësdrejtori i shërbimeve mbështetëse, drejtori i drejtorisë së financës, administratës dhe prokurimeve dhe përgjegjësi i sektorit të administratës, duke zbatuar procedurat standarde të testimit vetëm me intervistë. Emërimi i tyre bëhet nga drejtori i përgjithshëm, në përputhje me pikën 3 të nenit 19 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Ky personel i nënshtrohet një periudhe prove tremujore, duke filluar nga data e emërimit. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, me plotësimin e afatit, bazuar edhe në vlerësimin e eprorit direkt të punonjësit në provë, i propozon drejtorit të përgjithshëm emërimin ose jo të punonjësit. Drejtori i përgjithshëm, brenda 5 ditëve, vendos emërimin ose jo të punonjësit në periudhë prove.

11. Pezullimi dhe lirimi nga administrata tatimore qendrore

11.1 Pezullimi dhe lirimi i nëpunësve të administratës tatimore bëhen sipas përcaktimeve të neneve 21 e 22 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

11.2 Kur vendet e punës shkurtohen, si rrjedhojë e riorganizimit ose e reformave, punonjësve u ofrohen pozicione të së njëjtës kategori, brenda sistemit të administratës tatimore qendrore dhe, kur nuk është e mundur, pozicione të një shkalle më të ulët, me kusht që ata të plotësojnë kërkesat e pozicionit të ri.

11.3 Kur punonjësit e shkurtuar të të gjitha kategorive:

a) nuk plotësojnë kërkesat e pozicionit të ri;

b) dalin mbi numrin e përgjithshëm të vendeve të punës në dispozicion, emrat e tyre shënohen në listë pritjeje, për një periudhë 1-vjeçare, për t'u emëruar, pa konkurrim, me kusht që të plotësojnë kërkesat e vendit të punës, të mbetur të lirë.

11.4 Punonjësi vazhdon të gëzojë të drejtat e vendit të tij të mëparshëm deri sa t'i ofrohet një vend tjetër, por jo më tepër se 1 vit. Në rast refuzimi të vendit të punës së ofruar, punonjësit i humbasin të drejtat e mësipërme. Punonjësit, pas përfundimit të afatit njëvjeçar, kanë të drejtë të përfitojnë nga trajtimi të papunë, sipas legjislacionit në fuqi.

12. Transferimi i detyrueshëm brenda së njëjtës kategori

12.1 Transferimi i detyrueshëm për punonjësit e administratës tatimore realizohet në përputhje me nenin 17 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", sipas procedurave për institucionet e pavarura.

13. Dhënia e lejes pa të drejtë page

13.1 Punonjësi, me kusht që të mos ketë çështje, disiplinore a penale, në shqyrtim ndaj tij, ka të drejtë që, për arsye shëndetësore, personale, për fëmijët, bashkëshortin apo prindërit, të kërkojë leje të papaguar, brenda një viti kalendarik, jo më shumë se 30 ditë. Në bazë të arsyeve të parashtuara dhe nevojave operacionale të administratës tatimore, drejtori i përgjithshëm i tatimeve e pranon ose refuzon këtë leje.

14. Dorëheqja dhe kërkesa për rikthim

Punonjësi që, për arsye personale, jep dorëheqjen nga shërbimi tatimor, por më pas dëshiron të rikthehet në këtë shërbim, i nënshtrohet procedurave të konkurrit për kandidatët e jashtëm.

III Procedura disiplinore

15. Shkeljet dhe komiteti disiplinor

15.1 Në përputhje me nenin 22 të ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", dhe me vendimin nr.306, datë 13.6.2000 të Këshillit të Ministrave, drejtori i përgjithshëm i tatimeve shqyrton rastet e shkeljeve të evidentuara nga punonjësit e tjerë dhe miraton masat disiplinore, në cilësinë e eprorit direkt.

15.2 Përbëjnë shkelje disiplinore:

- a) thyerja e dispozitave të legjislacionit tatimor dhe të akteve të tjera, dalë në zbatim të tij;
- b) shkelja e dispozitave të nenit 26 të ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", për shmangien e konfliktit të interesit;
- c) shkelja e rregullave për ruajtjen e konfidencialitetit, sipas kërkesave të nenit 25 të ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë";
- ç) moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale;
- d) mosrespektimi i përsëritur i kohës dhe i orarit të punës, moskryerja e detyrave apo mosrespektimi i përsëritur i afateve të caktuara për kryerjen e detyrave;
- dh) sjellja e parregullt gjatë kohës së punës me eprorët, kolegët, vartësit dhe me publikun;
- e) dëmtimi i pronës shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar, krijimi, pa shkaqe të pranueshme, i mundësisë për dëmtimin a keqpërdorimin e pronës shtetërore;
- ë) Kryerja, brenda apo jashtë kohës së punës, e veprimeve që ulin ose cenojnë figurën e punonjësit të administratës tatimore;
- f) kryerja e punëve apo veprimtarive, të cilat cenojnë interesat e detyrës zyrtare ose që pengojnë përmbushjen e saj;
- g) shkelja e ligjit nr.9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike";
- gj) shprehja e mendimeve apo kryerja e veprimtarive publike, me karakter partiak.

15.3 Për shqyrtimin e rasteve të përcaktuara me shkronjat "a" e "b" të pikës 2 të nenit 22 të ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", drejtori i përgjithshëm i tatimeve ngre komitetin disiplinor, me 5 (pesë) anëtarë, i cili kryesohet nga zëvendës drejtori i përgjithshëm i shërbimeve mbështetëse dhe ka në përbërje drejtorin/shefin e burimeve njerëzore dhe 3 nëpunës, të kategorisë A.

Rolin e sekretariatit të komitetit disiplinor e luan një punonjës i drejtorisë së burimeve njerëzore. Komiteti disiplinor i merr vendimet me shumicë votash. Në mbledhjet e këtij komiteti merr pjesë, pa të drejtë vote, në rolin e këshilltarit ligjor, një specialist, jurist, nga drejtoria juridike.

15.4 Komiteti disiplinor merret me të gjithë personelin e administratës tatimore, me përjashtim të drejtorit të përgjithshëm, zëvendësdrejtorëve të përgjithshëm dhe drejtorit të drejtorisë së apelimit tatimor, për të cilët masat disiplinore merren në përputhje me ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

15.5 Komiteti disiplinor, në trajtimin e punonjësve, garanton zbatimin e rregullave dhe të procedurave disiplinore, të parashikuara në këtë vendim e në legjislacionin për nëpunësit civil, dhe mbështetet në parimet e drejtësisë e të barazisë.

15.6 Në rast se anëtar i komitetit e ka të pamundur paraqitjen në mbledhjet e komitetit, zëvendësohet, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

15.7 Në rastet kur anëtarë të komitetit disiplinor, janë drejtuesit raportues të punonjësit të akuzuar, apo kur ata vetë janë nën akuzë, atëherë këta anëtarë zëvendësohen, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në pikën 15.6 të këtij vendimi, dhe shërbejnë vetëm si zyrtarë raportues në procedurën disiplinore.

15.8 Vendimet disiplinore merren kur sigurohet shumica e thjeshtë e votave të të gjithë anëtarëve të komitetit.

15.9 Për të gjitha mbledhjet, seancat dëgjimore dhe procedurat disiplinore, të zhvilluara nga komiteti disiplinor, mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komitetit.

16. Procedurat e trajtimit të shkeljeve

16.1 Në rast shkeljesh, eprori direkt kryen një verifikim paraprak, për të vërtetuar faktet dhe, kur është e nevojshme, merr deklarime nga çdo dëshmitar i mundshëm. Rezultate përmblidhen në një raport vlerësimi. Nëse nga verifikimi disiplinor vërtetohet se është bërë një shkelje disiplinore, eprori direkt e njofton punonjësin menjëherë me shkrim për shkeljet që rëndojnë mbi të.

16.2 Eprori direkt, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për shkeljen, i dërgon vendimin dhe një raport vlerësimi komitetit disiplinor, i cili është i detyruar ta vlerësojë këtë çështje brenda 30 ditëve nga data e marrjes së tyre. Komiteti mund t’i kërkojë drejtorisë përkatëse të administratës tatimore të sigurojë të gjitha të dhënat e nevojshme për vlerësimin e çështjes.

16.3 Pas shqyrtimit të plotë të dokumentacionit përkatës, komiteti disiplinor organizon një seancë dëgjimore, gjatë së cilës punonjësi i akuzuar ka të drejtë ta shpjegojë çështjen dhe t’u përgjigjet akuzave të bëra. Punonjësi i akuzuar gëzon të drejtën e ndihmës ligjore me shpenzimet e veta. Ai dhe dëshmitarët e çështjes njoftohen, me anë të aktit të njoftimit, për të marrë pjesë në seancën dëgjimore. Akti i njoftimit përfshihet në dosjen e seancës së komitetit disiplinor.

16.4 Bazuar në faktet e vërtetuara dhe në të dhënat e grumbulluara, sipas natyrës dhe rëndësisë së shkeljes, komiteti disiplinor i rekomandon drejtorit të përgjithshëm të tatimeve hedhjen poshtë të çështjes apo marrjen e masave, sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil.

16.5 Propozimi i masave bëhet sipas dëmit të shkaktuar. Në rastet kur vërehen dy ose më shumë shkelje, të përsëritura brenda një viti, komiteti mund të propozojë masën e largimit nga puna.

16.6 Për masat e vërtetimit të mitmarrjes apo të një kërkesë për shpërblim a për marrje të tij, zbatohet, në mënyrë të drejtpërdrejtë, masa “Largim nga puna”.

16.7. Drejtori i përgjithshëm i tatimeve ka autoritetin ligjor që, brenda 30 ditëve:

a) të pranojë rekomandimin e komitetit disiplinor dhe të marrë vendim përfundimtar, me shkrim. Drejtoria e Burimeve Njerëzore përgjigjet për zbatimin e vendimit dhe për njoftimin me shkrim të punonjësit, ndaj të cilit është marrë masa disiplinore. Një kopje e këtij vendimi arkivohet në dosjen e çështjes;

b) të mos pranojë rekomandimin e komitetit disiplinor dhe t’ia kthejë çështjen për rishqyrtim këtij komiteti, për arsye të dokumentuara, të mungesës së provave, të të dhënave apo të verifikimeve shtesë të kërkuara;

c) të mos pranojë rekomandimin e komisionit disiplinor, pas rishqyrtimit, kur arsyet për këtë vendim mbështeten nga një raport me shkrim.

16.8 Një kopje e vendimit për masë disiplinore, marrë ndaj punonjësit tatimor, depozitohet në dosjen e tij personale.

16.9 Administrata tatimore, kur shkelja disiplinore u nënshtrohet dispozitave të Kodit Penal,

siguron që hetimi, i plotë dhe i duhur, për të pranuar apo për të refuzuar një shkelje të tillë, të kryhet nga autoritetet përkatëse. Pavarësisht nga hetimi dhe se nga kush është vënë re shkelja, eprori direkt i punonjësit të akuzuar i propozon komisionit disiplinor njërën nga masat disiplinore, të parashikuara nga legjislacioni përkatës në fuqi.

17. Apelimi i vendimeve

Procedurat e apelimit ndaj vendimeve disiplinore të administratës tatimore rregullohen me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe me aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij.

Për sa nuk parashikohet në këtë vendim zbatohen dispozitat e statusit të nëpunësit civil dhe aktet nënligjore, në zbatim të tij.

18. Dispozita kalimtare

Pranimet apo ngritjet në detyrë, të bëra në kundërshtim me sa është parashikuar në këtë vendim, i nënshtrohen konkurrimit, sipas procedurave të përcaktuara në këtë akt, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Kategoria	Kriteret arsimore, kualifikimi dhe përvoja	Njohuritë dhe aftësitë kryesore profesionale
Drejtori i përgjithshëm (Nivel i lartë drejtues)	- Të ketë arsim të lartë në shkencat ekonomike dhe/ose juridike; - Të jenë figura të njohura në administratën publike dhe të kenë njohuri në fushën ekonomike, financiare dhe juridike; - Njohuri të gjuhëve të huaja. Përparësi: 1) Arsimim jashtë vendit; 2) Grada pasuniversitare master/doktoraturë në fushat e mësipërme; 3) Gjuhë e dytë e huaj	- Njohje të gjerë e aktivitetit kryesor të administratës tatimore; - Njohje të gjerë të strukturës organizative të administratës tatimore dhe përgjegjësi të sektorëve të ndryshëm të organizatës; - Njohje të gjerë të strukturës ligjore dhe rregulluese të qeverisë; - Njohje të gjerë të sektorëve dhe të praktikave të biznesit; - Të ketë aftësi planifikuese; - Të jetë analist i thellë i informacioneve të ndryshme dhe të ndërlikuara; - Të ketë aftësi vendimmarrëse dhe strategjike; - Të ketë aftësi komunikimi bindëse dhe autoritare; - Të ketë aftësi drejtuese dhe menaxhuese të burimeve njerëzore; - Të përcaktojë dhe menaxhojë bazuar në treguesit e performancës; - Të ketë aftësi vlerësuese të stafit në vartësi.
Zëvendësdrejtori i përgjithshëm (Nivel i lartë drejtues)	- Të ketë arsim të lartë sipas fushës që mbulojnë. - Figura të njohura dhe ekspertë në fushën që mbulojnë dhe të plotësojnë kriteret e përgjithshme të nëpunësve të shërbimit civil; - Të kenë njohuri të gjuhëve të huaja. Përparësi: 1) Arsimim jashtë vendit; 2) Grada pasuniversitare master/doktoraturë në fushat e mësipërme; 3) Gjuhë e dytë e huaj.	- Njohje të gjerë të aktivitetit kryesor të administratës tatimore; - Njohje të gjerë të strukturës ligjore dhe rregulluese të qeverisë; - Njohje të thellë të legjislacionit tatimor dhe pjesës tjetër të legjislacionit që ka lidhje me atë tatimor; - Njohje të thellë të funksioneve dhe operacioneve që do të menaxhojnë dhe do të kenë në vartësi; - Të jetë largpamës, të ketë aftësi analitike, aftësi vendimmarrëse, aftësi negociuese dhe aftësi drejtuese dhe menaxhuese të burimeve njerëzore; - Të ketë aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe bashkëveprimi; - Të përcaktojë dhe menaxhojë bazuar në treguesit e performancës dhe të ketë aftësi vlerësuese të stafit në vartësi.
Drejtor drejtorie në DPT dhe drejtor i drejtorisë rajonale	- Diplomë në ekonomi ose drejtësi në vartësi të funksionit që menaxhon (për funksionet e veçanta sipas pikës 5.3 të VKM-së); - Minimumi 2 vjet punë në administratën tatimore ose të jenë rekrutuar sipas procedurave të konkurrimit të hapur;	- Njohje të gjerë të aktivitetit kryesor të administratës tatimore; - Njohje e gjerë e ligjeve tatimore dhe e administrimit të tatimeve; - Njohje e thellë e funksioneve dhe procedurave që menaxhon në mënyrë direkte;

Kategoria A	- Njohuri të gjuhëve të huaja. Përparësi: 1) Arsimim jashtë vendit; 2) Grada pasuniversitare master/doktoraturë në fushat e mësipërme.	- Të ketë aftësi planifikuese dhe organizuese, aftësi analitike, aftësi vendimmarrëse; - të ketë aftësi menaxhuese të burimeve njerëzore, bazuar në treguesit e performancës, si dhe aftësi vlerësuese të stafit në vartësi.
Përgjegjës sektori në drejtorinë e përgjithshme Kategoria B	- Diplomë universitare në ekonomi ose drejtësi (për funksionet e veçanta sipas pikës 5.3 të VKM-së); - Të ketë punuar, pa ndërprerje, dy vjet në kategorinë C1; - Të jenë rekrutuar sipas procedurave të konkurrimit të hapur. Përparësi: 1) Arsimim jashtë vendit; 2) Gradë pasuniversitare master në fushat e mësipërme; 3) Njohja e gjuhës angleze.	- Njohje të gjerë të aktivitetit kryesor të administratës tatimore; - Njohje e gjerë e legjislacionit tatimor - Njohje e thellë e funksionit që mbulon sektori që menaxhon; - Të ketë aftësi planifikuese dhe organizuese, aftësi menaxhuese të burimeve njerëzore dhe vlerësuese të stafit në vartësi.
Inspektor në drejtorinë e përgjithshme Kategoria C2	Diplomë universitare në ekonomi ose drejtësi (për funksionet e veçanta sipas pikës 5.3 të VKM-së); - Përvojë pune 2-vjeçare në administratën tatimore; - Të jetë përzgjedhur sipas procedurave të konkurrimit të hapur. Përparësi: Njohja e anglishtes dhe diplomat pasuniversitare master.	- Të njohë shumë mirë legjislacionin tatimor; - Të njohë shumë mirë procedurat dhe funksionet që mbulon; - Të kuptojë shumë mirë aktivitetin e DPT; - Të ketë aftësi shumë të mira gjyqësore.
Drejtor i drejtorisë rajonale Kategoria A	- Diplomë në një fushë ekonomike dhe/ose juridike; - Të ketë punuar, pa ndërprerje, 2 (dy) vjet në kategorinë B; - Të ketë rekrutuar sipas procedurave të konkurrimit të hapur; - Përparësi: Njohje e gjuhës angleze, diploma pasuniversitare.	- Njohje të gjerë të aktivitetit kryesor të administratës tatimore; - Njohje të thellë të legjislacionit tatimor dhe procedurave tatimore; - Njohje të gjerë të fushave dhe praktikave të biznesit; - Të ketë aftësi menaxhuese të burimeve njerëzore dhe të punës në grup; - Të ketë aftësi organizative, aftësi bashkëpunuese, komunikuese; - Të jetë largpamës, të ketë aftësi analitike dhe vendimmarrëse.
Drejtor drejtorie në drejtorinë rajonale të tatimeve Kategoria B	- Diplomë në ekonomi ose drejtësi në vartësi të funksionit që menaxhon (për funksionet e veçanta sipas pikës 5.3 të VKM-së); - Të jetë rekrutuar sipas procedurave të konkurrimit të hapur. - Përparësi: Njohje e gjuhës angleze dhe diploma pasuniversitare.	- Njohje të gjerë të aktivitetit kryesor të administratës tatimore; - Njohje e gjerë e ligjeve tatimore dhe e administrimit të tatimeve; - Njohje e thellë e funksioneve dhe procedurave që menaxhon në mënyrë direkte; - Të ketë aftësi planifikuese dhe organizuese, aftësi analitike, aftësi vendimmarrëse;

		- Të ketë aftësi menaxhuese të burimeve njerëzore, si dhe aftësi vlerësuese të stafit në vartësi;
Përgjegjës sektori/zyre në drejtorinë rajonale të tatimeve dhe përgjegjës zyre në drejtorinë e përgjithshme	- Diplomë universitare në ekonomi ose drejtësi (për funksionet e veçanta sipas pikës 5.3 të (VKM-së); Përvojë pune 2 - vjeçare në administratën tatimore. Përparësi: Njohja e gjuhës angleze dhe diploma pasuniversitare.	- Njohje të gjerë të aktivitetit kryesor të administratës tatimore; - Njohje e gjerë e legjislacionit tatimor; - Njohje e thellë e funksionit që mbulon sektori të cilin menaxhon; - Të ketë aftësi planifikuese dhe organizuese, aftësi menaxhuese të burimeve njerëzore dhe vlerësuese të stafit në vartësi.
Kategoria C1		

Kategoritë C2 dhe C3 duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë aneks për kategorinë C1.

VENDIM
Nr.1189, datë 20.8.2008

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “MYHEJAN 1”, “MYHEJAN 2” E “MYHEJAN 3”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues, për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve “Myhejan 1”, “Myhejan 2” e “Myhejan 3” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit, prej 3 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Dardania” sh.p.k.
3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Myhejan 1”, “Myhejan 2” e “Myhejan 3”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.
4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1190, datë 20.8.2008

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “FTERRE”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”,

të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues, për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Fterre” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit, prej 3 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Velo” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Fterre”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1191, datë 20.8.2008

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “LANGARICA 3”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Langarica 3” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit, prej 3 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Energia Pulita” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Langarica 3”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1192, datë 20.8.2008

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “QAFËZEZ”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të

ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Qafëzez” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
 2. Miratimin e bonusit, prej 3 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Çaushi” sh.p.k.
 3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Qafëzez”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.
 4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1193, datë 20.8.2008

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “KOKA 1”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Koka 1”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës..
 2. Miratimin e bonusit, prej 3 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Dushi” sh.p.k.
 3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Koka 1”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.
 4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1194, datë 29.8.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË GJASHTË AUTOKOLONAVE DHE TRUPAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të

huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datat 30 gusht 2008 dhe 5 e 6 shtator 2008, dhe Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datat 31 gusht 2008 dhe 8 shtator 2008, të 6 (gjashtë) autokolonave dhe trupave ushtarake italiane, të përbëra, përkatësisht:

- Autokolona e parë, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete dhe 32 (tridhjetë e dy) trupa ushtarake.

- Autokolona e dytë, me 10 (dhjetë) automjete dhe 20 (njëzet) trupa ushtarake.

- Autokolona e tretë, me 6 (gjashtë) automjete dhe 57 (pesëdhjetë e shtatë) trupa ushtarake.

- Autokolona e katërt, me 12 (dymbëdhjetë) automjete dhe 40 (dyzet) trupa ushtarake.

- Autokolona e pestë, me 9 (nëntë) automjete, nga të cilat 1 (një) ushtarak dhe 8 (tetë) të tjerat civile, dhe 2 (dy) trupa ushtarakë e 9 (nëntë) civilë.

- Autokolona e gjashtë, me 13 (trembëdhjetë) automjete dhe 40 (dyzet) trupa ushtarake.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për dy autokolonat e para dhe trupat ushtarake italiane të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit, në datën 30 gusht 2008.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën e tretë dhe të gjashtë dhe trupat ushtarake italiane të jetë pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë, përkatësisht, në datat 31 gusht 2008 dhe 8 shtator 2008.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën e katërt dhe të pestë dhe trupat ushtarake italiane të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë, dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit, përkatësisht, në datat 5 e 6 shtator 2008.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Autokolonat dhe trupat ushtarake italiane, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM Nr.1199, datë 27.8.2008

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR
NDËRMJET MINISTRISË SË MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
DHE “POLAR”, SHPK, PËR BURIMIN UJOR 6/1, UJI I FTOHTË, VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006

“Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe “POLAR” sh.p.k-së, për burimin ujqor 6/1, Uji i Ftohtë, Vlorë, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe këshilli i basenit ujëmbledhës, Vjosë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.1, datë 20.8.2008

PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE, NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE, PËR VITIN 2008

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “dh” të nenit 34/1 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Kostoja mesatare e ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, në shkallë republike, për vitin 2008, të jetë 33 464 (tridhjetë e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë/m², sipërfaqe shfrytëzimi.

2. Kostoja mesatare e ndërtimit dhe vlera mesatare e apartamenteve, në tregun e lirë të banesave, sipas qyteteve, për vitin 2008, është sipas tabelave 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi.

3. Për qytetet, për të cilat nuk është nxjerrë kostoja mesatare e ndërtimit, do të zbatohet kostoja e qytetit më të afërt, e përcaktuar në tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

4. Për vlerën mesatare të apartamenteve në tregun e lirë, në zonat, që nuk përfshihen në tabelën 2, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi, nuk do të përdoret referimi në zonën më të afërt.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA NR.1

KOSTOJA MESATARE E NDËRTIMIT PËR VITIN 2008

Në vlerën e koston mesatare nuk janë përfshirë vlerat e:

1. rrjetit inxhinierik,
2. projektit,
3. studimit gjeologjik,
4. lejes së ndërtimit,
5. truallit,
6. shpenzimeve operationale të EKB-së 4%.

Nr.	Qytetet	Çmimi për njësi (mesatare aritmetike)	
		Sip.shfrytëzimi	Sip.ndërtimi
1	Berat	33 187	27 450
2	Dibër	34 842	28 826
3	Durrës	35 195	29 108
4	Elbasan	31 532	26 081
5	Ersekë	33 544	27 742
6	Fier	33 499	27 710
7	Gramsh	32 096	26 551
8	Gjirokastër	33 876	28 024
9	Korçë	33 427	27 640
10	Krujë	33 228	27 490
11	Kavajë	33 526	27 736
12	Kuçovë	32 982	27 279
13	Kukës	35 494	29 366
14	Laç	32 739	27 082
15	Lezhë	33 745	27 906
16	Librazhd	31 805	26 307
17	Lushnjë	33 311	27 555
18	Burrel	35 539	27 744
19	Përrenjas	31 990	26 459
20	Peqin	31 945	26 425
21	Përmet	33 905	28 045
22	Pogradec	33 368	27 594
23	Pukë	33 961	28 092
24	Rrëshen	32 978	27 281
25	Çorovodë	33 552	27 759
26	Sarandë	33 387	27 617
27	Shkodër	33 830	27 981
28	Tepelenë	33 706	27 891
29	Bajram Curri	35 872	29 679
30	Tiranë	33 174	27 439
31	Vlorë	34 156	28 252
	Kostoja mesatare	33 464	27 681

V.O. Për qytetet që nuk janë përfshirë në listë, si kosto mesatare të merret kostoja mesatare e qytetit më të afërt.

TABELA NR.2

TË DHËNAT E TREGUT TË LIRË TË APARTAMENTEVE SIPAS QYTETEVE
PËR VITIN 2008

Nr.	Qytetet	Kostoja mesatare e shitjes lek/m ² sip.shfrytëzimi në tregun e lirë
1	Tiranë	81 875
2	Vlorë	45 000
3	Kamëz	44 000
4	Krrabë	24 505
5	Durrës	70 586

6	Kavajë	56 757
7	Shijak	42 000
8	Shkodër	49 540
9	Pukë	13 778
10	Laç-Vau i Dejës	24 000
11	Koplik	43 827
12	Fushë-Arrëz	8 157
13	Lezhë	48 475
14	Shëngjin	48 100
15	Vlorë	50 988
16	Orikum	49 000
17	Himarë	50 000
18	Korçë	44 926
19	Pogradec	43 273
20	Bilisht	34 781
21	Ersekë	26 352
22	Maliq	29 589
23	Leskovik	20 838
24	Fier	55 062
25	Lushnjë	40 107
26	Ballsh	34 824
27	Patos	29 018
28	Divjakë	46 533
29	Roskovec	31 079
30	Berat	35 340
31	Kuçovë	24 460
32	Polican	18 633
33	Çorovodë	12 488
34	Ura Vajgurore	21 807
35	Elbasan	46 600
36	Librazhd	38 886
37	Cërrik	33 067
38	Gramsh	32 127
39	Peqin	37 399
40	Përrenjas	33 902
41	Rrogozhinë	37 000
42	Gjirokastër	53 731
43	Përmet	23 564
44	Sarandë	55 000
45	Delvinë	40 000
46	Tepelenë	15 940
47	Memaliaj	11 155
48	Këlcyrë	15 423
49	Konispol	30 000
50	Libohovë	29 000
51	Laç	41 876
52	Krujë	41 200
53	Fushë-Krujë	38 200
54	Mamurras	28 570
55	Milot	27 506
56	Rrëshen	43 000
57	Kukës	27 966
58	Tropojë	22 500

59	Krumë	28 833
60	Peshkopi	35 600
61	Burrel	27 700
62	Bulqizë	30 000

TABELA NR.2

TË DHËNAT E TREGUT TË LIRË TË APARTAMENTEVE PËR VITIN 2008

Qyteti i Tiranës

Nr.	Zonat	Vlera mesatare e shitjes lekë/m ² sip.shfrytëzimi
1	1/1	90 000
2	1/2	67 500
3	2/1	160 000
4	2/2	120 000
5	2/3	105 000
6	2/4	115 000
7	2/5	80 000
8	3/1	77 500
9	3/2	62 500
10	4/1	67 500
11	4/2	62 500
12	5/1	175 000
13	5/2	112 500
14	5/3	100 000
15	5/4	82 500
16	6	67 500
17	7/1	117 500
18	7/2	117 500
19	7/3	85 000
20	7/4	65 000
21	8/1	102 500
22	8/2	87 500
23	8/3	67 500
24	9/1	130 000
25	9/2	102 500
26	9/3	80 000
27	10/1	140 000
28	10/2	130 000
29	10/3	120 000
30	11/1	85 000
31	11/2	70 000
32	11/3	65 000

UDHËZIM

Nr.2, datë 1.8.2008

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.848, DATË 11.6.2008
 “PËR KTHIMIN E FONDEVE FINANCIARE NGA SUBJEKTET, QË KANË PËRFITUAR
 NGA PËRDORIMI I FONDEVE TË GRANTEVE JAPONEZE SI MBËSHTETJE
 BUXHETORE “NON PROJECT GRAND AID” (NPGA), PËR SEKTORIN E BUJQËSISË**

DHE USHQIMIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.848, datë 11.6.2008 “Për kthimin e fondeve financiare nga subjektet, që kanë përfituar nga përdorimi i fondeve të granteve japoneze si mbështetje buxhetore “Non Project Grand Aid” (NPGA), për sektorin e bujqësisë dhe ushqimit të Këshillit të Ministrave”, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konusmatorit dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1. Të gjitha subjektet përfituese të NPGA (Non Project Grand Aid), që janë financuar nga njësia e menaxhimit të projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2 KR”, për periudhën nga 1999 e në vazhdim, të lidhin kontratë të shitjes me rezervë me projektin “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” për linjat teknologjike të agropërpunimit.

2. Autorizohet drejtori i projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” për lidhjen dhe nënshkrimin e kontratave me subjektet përfituese.

3. Vlera financiare e përfituar për linjat teknologjike, që janë financuar nga “Non Projekt Grant Aid” në kuadër të granteve japoneze, të shlyhen si fonde kundërparti nga subjektet përfituese me këste, pa interes, me vlerën e barasvlefshme në “lekë” të çmimit të blerjes FOB, deri në qershor të vitit 2013. Konvertimi në lekë i çmimit të blerjes FOB të bëhet sipas kursit zyrtar të këmbimit të valutës në lekë, në datën 11.6.2008 sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.848, datë 11.6.2008.

4. Projekti “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” të lidhë kontratat me subjektet përfituese me afat deri në fund të qershorit të vitit 2013.

5. Diferencat financiare ndërmjet çmimeve CIF dhe FOB, të evidentohen nga projekti “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” në pakësim të fondeve kundërparti.

6. Brenda strukturës organizative të miratuar të sektorit të fondit kundërparti, drejtori i projektit ngarkon specialistë të veçantë për monitorimin, menaxhimin e linjave dhe kthimin e fondit kundërparti nga çdo subjekt. Këta specialistë mbajnë dokumentacion të plotë dhe ndjekin punën për shlyerjen e vlerës së përcaktuar të linjave të agropërpunimit.

7. Projekti “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR”, në bashkëpunim me organet tatimore, ka të drejtë të ushtrojë kontroll teknik e financiar mbi veprimtarinë ekonomike që subjekti kryen, gjendjen teknike etj., për disa kohë që nuk është paguar kësti i fundit.

8. Subjekti përfitues është i detyruar të raportojë e të japë informacion në projektin “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” për të dhënat që i kërkojnë prej tij dhe mban përgjegjësi për saktësinë e tyre.

9. Numri i kërkesave për çdo vit kalendarik të jetë 2-3, ky numër përcaktohet në mirëkuptim midis palëve dhe do të pasqyrohet në kontratë.

10. Kuotat e arkëtimit të kësteve përcaktohen në mirëkuptim midis palëve dhe do të pasqyrohen në kontratën e lidhur midis projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” dhe subjekteve përfituese të NPGA-së.

11. Subjekti përfitues mund të bëjë në çdo kohë likuidim të menjëhershëm të disa kësteve, kjo e parashikuar në kontratën ndërmjet palëve.

12. Për rastet e mospagimit në kohë të këstit, subjekti përfitues i linjave të agropërpunimit penalizohet me një kamatëvonesë vjetore prej 5% të vlerës së papaguar të këstit, e llogaritur kjo për çdo ditë pune.

13. Në rast se subjekti përfitues nuk pranon të nënshkruajë kontratën me projektin “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” apo nuk paguan këstet e radhës, organet tatimore në bashkëpunim me projektin “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR”, kryejnë bllokimin e aktivitetit ekonomik të subjektit dhe nisin procedurat e sekuestrimit të linjës së agropërpunimit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

14. Kur subjekti përfitues, pagues i rregullt i kësteve, nuk paguan dy këste të radhës të cilat janë të pasqyruara në kontratë, linja e agropërpunimit sekuestrohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, pa asnjë rimbursim të kësteve të mëparshme.

15. Në rast sekuestrimi, organet kompetente bllokojnë veprimtarinë ekonomike të subjektit dhe projekti “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” planifikon punën për çmontimin e linjës dhe

rishpërndarjen e saj në subjekte të reja përfituese, duke respektuar udhëzimet në fuqi.

16. Kalimi i pronësisë së linjave të agropërpunimit nga projekti “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” te subjekti përfitues, bëhet vetëm pasi ky i fundit të ketë likuiduar edhe këstin e fundit në përputhje me kontratën duke shlyer vlerën FOB të linjës.

17. Të gjitha arkëtimet e kryera nga subjektet përpara lidhjes së kontratës, të provuara nga ana e tyre si arkëtime në favor të projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” për likuidimin e linjës do të përfshihen në pagesën e kështit/-ve të fundit.

18. Nuk përbëjnë arkëtim në favor të projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” të gjitha arkëtimet të kryera ndaj të tretëve, agjentë sigurimesh etj., si dhe çdo pagesë tjetër që nuk ka mbërritur në llogarinë e projektit 2KR.

19. Me mbylljen e arkëtimeve që përbën vlerën e plotë të detyrimit kontraktual, projekti “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” i kalon pronësinë subjektit përfitues duke e pajisur atë me “Vërtetim pronësie”.

20. Për rastet e patrajtuara nga ky udhëzim, nëse gjykohet për efekt të faktorëve objektivë, me propozim të drejtorit të projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR”, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit përcakton mënyrën e zgjidhjes me urdhër të veçantë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Jemin Gjana

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

KËRKESË **Nr.3699/1, datë 21.8.2008**

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Sarandë - Krane - Konispol.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afatit për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Ky publikim bëhet vetëm për pasurinë e llojit tokë (arë dhe truall), ndërsa objektet dhe drufrutorët do të publikohen në një fazë të dytë, pasi të jenë kryer verifikimet nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Pronarët për të cilët në kolonën “shënime” në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “i pakonfirmuar”, “pretendim pronësie” dhe “rikonformim”, duhet të aplikojnë për regjistrimin e pasurive për të cilat pretendojnë pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme Sarandë. Me mbarimin e afatit njëmuor nga dita e parë e publikimit, këto pasuri do të përjashtohen nga shpronësimi, nëse nuk paraqitet konfirmim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Sarandë, lidhur me titullin e pronësisë për pronarin pretendues.

Pronarët për të cilët në kolonën “shënime” në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për

interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 24 838 159.8 (njëzet e katër milionë e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë, pikë tetë) lekë.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA P.P.T.T.

DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE

Qarku: VLORE

Komuna: Markat, Fshati-Shales, nr. rendor 1-3.

**LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE SEGMENTIT RRUGOR
"SARANDE_KRANE_KONISPOL"**

Lloji i pasurise se paluajtshme: Toke Are

Nr .	PRONAR			Toke Are				Vlera Totale	Shenime
	Emri	Atesia	Mbiemri	Nr. i pasurise	Sip. m ²	Cmimi m ²	Vlera ne leke		
1	Hajder	Saraç	Bakullati	362/1	41	122.2	5010.2	5010.2	Konfirmuar nga ZRPP
2	Hajredin	Ismail	Bakullati	362/30	1000	122.2	122200	122200	Konfirmuar nga ZRPP
3	Abaz	Dine	Baduni	362/31	864	122.2	105580.8	105580.8	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI			1905		232791	232791	

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA P.P.T.T.
DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE

Qarku: VLORE

Komuna: Finiq, Fshatrat-Vrion-Finiq-Çlirim nr. rendor 1-29, 1-8, 1-7.

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE SEGMENTIT RRUGOR "SARANDE_KRANE_KONISPOL"

Lloji i pasurise se paluajtshme: Toke Are, Truall, Ullishte,

Nr.	PRONAR			Toke Are				Truall			Vlera Totale	Shenime
	Emri	Atesia	Mbiemri	Nr. pas	Sip. m ²	Cmimi m ²	Vlera ne leke	Sip. m ²	Cmimi m ²	Vlera ne leke		
1	Sotir	Stavro	Toto	1462	172	182.3	31355.6				31355.6	KONFIRMUAR NGA ZRPP
2	Koci	Llambi	Papa	1463	449	182.3	81852.7				81852.7	KONFIRMUAR NGA ZRPP
3	Jani	Koci	Papa	1464	81	182.3	14766.3				14766.3	KONFIRMUAR NGA ZRPP
4	Shtet			1467/1	78	182.3	14219.4				14219.4	PRETENDON HARALLAMB KOCI PAPA
5	Ilia	Spiro	Jani	1621	124	182.3	22605.2				22605.2	KONFIRMUAR NGA ZRPP
6	Misim	Ramadan	Pashaj	1625	117	182.3	21329.1				21329.1	KONFIRMUAR NGA ZRPP
7	Vasil	Vangjel	Çato	1626	110	182.3	20053				20053	KONFIRMUAR NGA ZRPP
8	Harallamp	Koci	Papa	1627	120	182.3	21876				21876	KONFIRMUAR NGA ZRPP
9	Riza Katerina	Miho	Manushi Maksakuli	2897 & 2896				80	732	58560	58560	KONFIRMUAR NGA ZRPP
10	Jani	Koci	Papa	1675	44	182.3	8021.2				8021.2	KONFIRMUAR NGA ZRPP
11	Lefter	Kristo	Papa	1676	26	182.3	4739.8				4739.8	KONFIRMUAR NGA ZRPP
12	Kristo	Llambi	Papa	1677	52	182.3	9479.6				9479.6	KONFIRMUAR NGA ZRPP
13	Leonidha	Mico	Qesko	1972	325	182.3	59247.5				59247.5	KONFIRMUAR NGA ZRPP
14	Leke	Gjon	Çupi	2020	80	182.3	14584				14584	KONFIRMUAR NGA ZRPP
15	Spiro	Thoma	Kallojeri	2022	80	182.3	14584				14584	KONFIRMUAR NGA ZRPP

	16	Thoma	Naci	Babi	2023	75	182.3	13672.5				13672.5	KONFIRMUAR NGA ZRPP
	17	Bexhet	Bastri	Allkushi	2046	160	182.3	29168				29168	KONFIRMUAR NGA ZRPP
